



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 15.10.2014, ora 11:00

Drejton mbledhjen

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
2. Projektligji “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Armando Subashi, Bashkim Fino, Ulsi Manja, Xhemal Qefalia, Dashamir Peza, Blendi Klosi, Armando Prenga, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Piro Lutaj, Tahir Muhedini, Petrit Vasili, Vexhi Muçmataj, Nard Ndoka, Mark Frroku, Tom Doshi dhe Silva Caka.

Mungojnë:

Mhill Fufi, Eduard Halimi, Oerd Bylykbashi, Spartak Braho, Edi Paloka, Gent Strazimiri, Arben Ristani, Keltis Kruja, Kastriot Islami, Gjovalin Bzheta dhe Fatmir Mediu.

Të ftuar:

Maksim Tashi – përfaqësues nga Drejtoria e Qarkullimit dhe Sigurisë Rrugore në Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës

Flamur Mullisi – përfaqësues nga Drejtoria e Qarkullimit dhe Sigurisë Rrugore

Nikolin Berxhiku – përfaqësues nga Drejtoria e Qarkullimit dhe Sigurisë Rrugore

Eni Culli – përfaqësues nga Drejtoria e Qarkullimit dhe Sigurisë Rrugore

Wolfgang Rusch – ekspert i SIGMA-s

Migena Kondo – përkthyes

Agnes Bernhard – zëvendësshef i Misionit EURALIUS

Koço Bendo – përfaqësues nga EURALIUS

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Përsëndetje!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve, meqenëse kuorumi është i realizuar.

Pika e parë e rendit të ditës, siç jeni në dijeni, është projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Përfaqësues nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës janë zotërinjtë: Maksim Tashi dhe Eni Culli, nga Drejtoria e Qarkullimit dhe Sigurisë Rrugore.

Faleminderit që jeni të pranishëm!

Besoj se do të bëni një paraqitje të përmbajtjes së projektit duke u ndalur në pikat kyçe të tij, pa u zgjatur për shkak se projekti është shumë i njohur për kolegët deputetë.

Së dyti, relatorë janë dy kolegët tanë, zoti Ulsi Manja dhe zoti Vexhi Muçmataj. Kemi caktuar dy relatorë për shkak të rëndësisë që ka ky projektligj për momentin në të cilin shqyrtohet dhe miratohet, për problemet e mëdha që kemi me sigurinë rrugore, por edhe për shkak sepse janë njohës shumë të mirë në sajë të përvojës së tyre personale, profesionale në këtë fushë. Unë i falënderoj të dy kolegët relatorë, sepse gjatë gjithë këtyre ditëve kanë pasur mundësi të takohen me ekspertë, specialistë të kësaj fushe dhe kanë bërë një punë të konsiderueshme për të ardhur këtu në këtë proces shqyrtimi në Komisionin e Ligjeve.

Nëse do të jetë e nevojshme që të kemi të ftuar të tjerë, do ta çmojnë relatorët dhe do të na i propozojnë.

Fillojmë me shqyrtimin në parim. Fillimisht do të dëgjojmë përfaqësuesit e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës në një paraqitje të përmbledhur të projektit.

Fjala për ju.

Maksim Tashi – Në kuadër të paraqitjes së masave të miratuara nga Komiteti Ndërmintor i Sigurisë Rrugore, Ministria e Transportit në bashkëpunim edhe me Ministrinë e Punëve të Brendshme ka përgatitur këto ndryshime të projektkodit rrugor. Kryesisht këto ndryshime janë në disa çështje, të cilat po i prek shkurtimisht pasi janë edhe në relacionin që ju kemi paraqitur.

Në aspektin e dëmtimit të personave në rrugë dhe sidomos në sinjalistikën rrugore, masat ndaj tyre rriten. Të gjitha gjobat që janë në Kod dhjetëfishohen edhe për ata që dëmtojnë rrugën, edhe për ata që bëjnë ndërhyrje të parregullta në rrugët kryesore interurbane. Kryesorja

në këto ndryshime që kemi paraqitur është përputhja e plotë e direktivës së lejeve të drejtimit me legjislacionin shqiptar. Përputhja e plotë parashikon tri faza.

Faza parë është ndryshimi i Kodit lidhur me përputhjen e lejeve të drejtimit. Faza e dytë është ndryshimi i vendimit të qeverisë, rregullorja e zbatimit të Kodit Rrugor dhe faza e tretë janë ndryshimet e udhëzimit përkatës. Me këto ndryshime bëhet përputhja e plotë e lejeve të drejtimit evropiane me ato shqiptare, që nga modeli, përgatitja, testimi, kualifikimi dhe provat për marrjen e lejes të drejtimit. Këto janë elemente kryesore që kemi paraqitur. Jemi pak të vonuar përkundrejt vendeve të Europës, sepse këto vende e kanë filluar mbas vitit 2013, kurse ne, kuptohet, themi ta fillojmë në vitin 2014 e tutje për lejet e drejtimit. Kjo ka qenë edhe një nga arsyet e vonesës. Ne deri më sot kemi punuar me direktivën, por direktiva 439 ka qenë e vlefshme deri në fund të vitit 2013, kurse tani ka hyrë direktiva 126, e cila fillon nga viti 2013 e tutje për vendet anëtare, kurse ne fillojmë në vitin 2014 e në vazhdim.

Besojmë se përveç anës teorike që është përgatitja, ndryshimet e Kodit, të vendimit të qeverisë dhe udhëzimeve, edhe zbatimi do të jetë 100 % me këto ndryshime që ne po bëjmë dhe po reflektojmë. Kjo nëpërmjet ushtrimit të kontrollove që do të forcohen në drejtim të sektorit ku bëhet ky aplikim që është Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor. Kuptohet që edhe ndihma e deputetëve do të jetë me vlerë. Çdo sugjerim do të mundohemi ta reflektojmë dhe të bëjmë përputhjen e detyrave që na ka vënë Brukseli.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Tani nga relatorët paraqitjen në parim do ta bëjë zoti Manja. Nëse zoti Muçmataj do të ketë diçka për të shtuar, mund ta shtojë dhe pastaj ai do të drejtojë debatin nen për nen.

Zoti Manja, ju lutem!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë të Komisionit të Ligjeve, siç u tha edhe nga kryetari, unë dhe zoti Muçmataj jemi caktuar si relatorë të këtij projektligji të rëndësishëm, por komisioni ynë në bazë të kalendarit 3-javor të punimeve të Kuvendit dhe të kalendarit të punës së këtij komisioni, për këtë projektligj komisioni ynë është për dhënie mendimi, që do të thotë se vlerësimi i parë që do të bëhet nga kolegët e Komisionit të Ligjeve, është vlerësim kushtetues dhe ligjor. Kjo do të thotë se projektligji “Për ndryshimet në Kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë” është në përputhje me Kushtetutën dhe kuadrin ligjor shqiptar.

Në vlerësimin tonë, projektligji i paraqitur bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në nenin 81, pika 1, si dhe ka respektuar me rigorozitet kërkesat e nenit 68 të Rregullores së Kuvendit, pasi projektligji si në formë edhe në përmbajtje është i shoqëruar me relacionin përkatës, ku nga ana e Këshillit të Ministrave shprehet qartë qëllimi dhe objektivat e këtij projektligji.

Siç u tha edhe nga përfaqësuesit e ministrisë, ndryshimet në Kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë kanë si objektiv të përgjithshëm rritjen e sigurisë rrugore dhe minimizimin e numrit të aksidenteve rrugore në Shqipëri dhe ky projektligj synon që së bashku me aktet nënligjore që do të dalin në zbatim të tij pas miratimit nga Kuvendi i Shqipërisë, të arrihet përputhshmëria e plotë me direktivën përkatëse të Bashkimit Europian.

Pa dashur të ndalem gjatë në risinë që sjellin këto ndryshime në Kodin Rrugor, dua të them që këto ndryshime paraqesin një sërë risish, por unë do të evidentoja ose të veçoja disa nga më kryesoret.

Së pari që në nenin 2 të projektligjit synohet detyrimi i çdo shkelësi apo kundërvajtësi që shkakton një dëm në sinjalistikën apo dëm të çdolloj natyre mbi sistemin rrugor të detyrohet t'i dëmshpërblejë Entin Pronar të Rrugëve të gjithë shpenzimet për rikthimin e rrugës në gjendjen fillestare.

Risia e dytë e projektligjit është fakti që te kategoria e shtetasve që do të pajisen me leje-drejtimi, përpos kërkesave të deritanishme që parashikon Kodi Rrugor, që lidhen me kontrollin shëndetësor dhe gjendjen psikike të aplikuesve për leje-drejtimi, projektligji parashikon edhe një vlerësim të gjendjes së personit nga pikëpamja e varësisë kronike nga alkooli ose nga lëndët narkotike. Pra, në këtë projektligj theksohet qartë që në rast se personi që aplikon për t'u pajisur me një leje drejtimi ka varësi nga alkooli ose lëndët narkotike, nuk do të pajiset me këto leje drejtimi. Sigurisht që në referencë të këtij vërtetimi, do t'i referohet Regjistrin Kombëtar të personave të regjistruar ose që kanë marrë trajtim nga alkooli dhe lëndët narkotike.

Risi tjetër e këtij projektligji është edhe detyrimi për drejtuesit e automjeteve që të pajisin mjetet me ndenjësë të posaçme për transportin e fëmijëve deri në 12 vjeç. Projektligji i ri parashikon edhe ndëshkimin e personave, të cilëve u ka kaluar afati i vlefshmërisë së lejeve të drejtimit.

Ajo që do të vlerësoja si risi mjaft esenciale e këtij projektligji është pajisja me një leje drejtimi të detyrueshme e personave që do të merren me transport pasagjerësh dhe konkretisht

detyrimi gjithmonë është për atë që do të merret me transportin e fëmijëve të shkollave. Për këto kategori personash është e detyrueshme pajisja me leje drejtimi të kategorisë “D”, “D₁”, “D₁E”, të cilat janë specifikime teknike që ndoshta në diskutimet nen për nen do të pasqyrohen ose do të bëhen më qartë transparente për publikun dhe për median.

Të nderuar kolegë!

Sigurisht që projektligji ka nevojë për përmirësime të karakterit teknik që unë dhe kolegu Muçmataj, por dhe kolegët e tjerë, rezervojmë të drejtën që, kur të diskutohet nen për nen, të bëjmë sugjerimet e nevojshme.

Si përfundim, dua të them se duke vlerësuar rëndësinë e miratimit të këtij projektligji, e mbështesim plotësisht nismën e qeverisë për këto ndryshime. Ndaj, të nderuar kolegë, ju ftoj ta miratojmë në parim këtë projektligj dhe pastaj nen për nen t’ia kalojmë seancës plenare për miratim.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Manja!

Faleminderit dhe një herë të dy kolegëve relatorë! Materialin e plotë të relatorëve kolegët deputetë e kanë përpara, e kanë marrë në kohë paraprakisht. Në atë material ka ndërhyrje në disa nene. Besoj edhe përfaqësuesit e ministrisë janë njohur me përmbajtjen e tyre. Kështu që do të kenë mundësi t’i reflektojnë gjatë diskutimit në seancën tjetër nen për nen. Gjithsesi, vazhdojmë. Kush ka pyetje në parim?

Po, zoti Klosi.

Blendi Klosi – Në fakt, kam një pyetje shumë teknike, që e kemi bërë dy vjet përpara kur ne kaluam këtë kod me konsensus. Nuk e di nëse do të jetë e mundur që të shikohet nga përfaqësuesit e ministrisë dhe pastaj të ndjekim procedurat parlamentare për të futur një ndryshim. Në momentin kur ka qenë një kërkesë e asaj kohe e grupit tonë parlamentar, nuk na u mor parasysh propozimi që të mos ketë makina në Shqipëri me timonin nga krahu i kundërt. A do të kemi nga ministria një përgjigje në parim dhe pastaj ta shohim mundësinë që ne ta bëjmë atë? Është e papranueshme mendoj për realitetin shqiptar që akoma kemi makina me timonë në krahë të ndryshëm. Është një pyetje teknike. E kemi pasur shqetësim para dy vjetësh. Do të donim një përgjigje nga ministria.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Jepni përgjigje për pyetjen e zotit Klosi.

Maksim Tashi – Mjetet me timon në krah të kundërt janë kryesisht në Angli dhe Anglia duke qenë se është vend anëtar i BE-së, ne nuk mund t'i ndalojmë mjetet me timon në krah të kundërt në regjistrim. Që të pengosh regjistrimin e këtyre mjeteve kur ato janë miratuar sipas standardit të BE-së, është shkelje e Ministrisë së Transporteve. Në qoftë se ne do të pranojmë që këtyre t'u bëhet modifikim, që do të thotë nga sistemi anglez ta kalojmë në sistem shqiptar, do të shkelet mbi 3 direktiva. Këtë e kemi të konfirmuar nga Brukseli, sepse kemi qenë me të njëjtin mendim, e kemi dëgjuar propozimin tuaj, kemi kontaktuar me Brukselin, i kemi propozuar një gjë të tillë se si mund ta bëjmë, por teorikisht është e pamundur.

Nuk është se nuk e lejojnë italianët. Me të shkruar asnjë vend nuk e pengon, sepse shkelet edhe konventa e trafikut për mjetet që janë të miratuara sipas standardit të OKB-së. Shkelen direktivat e BE-së për mjete të cilat janë miratuar sipas standardit të BE-së. Ekziston edhe një direktivë për regjistrimin e mjeteve, që çdo mjet i regjistruar në një vend të BE-së me leje qarkullimi të vlefshme në momentin që paraqitet në të gjitha vendet anëtare të BE-së, është i detyruar të regjistrohet automatikisht. Me një fjalë ashtu siç bëhet konvertimi i lejes së drejtimit bëhet dhe konvertimi i lejes së qarkullimit. Nuk ka pengesa të tilla të shkruara. Me vullnete politike pastaj, që të pengohet të hyjë në doganë mund të bëhet, por mos prisni nga Ministria e Transportit të shkelë direktivat për ndalimin e mjeteve me timon në krah të kundërt në regjistrim, aq më tepër në kontroll teknik. Me vullnet mund të bëni ju çfarë të doni.

Fatmir Xhafaj – T'i ndajmë gjërat. Ju e dhatë përgjigjen tuaj. Mund të jetë dhe kështu siç thatë ju, se ju jeni ekspert. As unë as kolegët nuk e ndajmë dot. Gjithsesi, le të ngelet një çështje për ju, le të ngelet dhe një çështje për relatorët për ta konsultuar nëse është një gjë e bëshme në standard dhe në praktika ndërkombëtare. Nëse nuk është ne nuk bëjmë gjëra ashtu siç thatë ju që ngelet në vullnetin tuaj. Ne e kemi vullnetin për të bërë ligj, por ligj brenda standardeve.

Fjalën e ka zoti Qefalia.

Xhemal Qefalia - Faleminderit!

Në fakt, pyetjen e kisha për dy ekspertët e ministrisë. Ky është një kod i cili miratuar vjet me shumicë votash, i kaluar në seancën plenare. Madje një ndër kushtet ka qenë për t'u votuar. Unë do të isha i interesuar të dija nëse ka arsye të tjera përveç direktivës 126 të Këshillit të Europës që ju detyrojnë ju ta sillni këtë draft për ta riparë?

Dhe e dyta, edhe në informacionin që dhatë ju, por edhe relatorët, shikojmë një dhjetëfishim të gjobave. Kjo bie në kurriz të qytetarëve. A keni statistika ju që keni arritur në këtë konkluzion që kanë qenë gjobat e vogla shkak që nëpër rrugët e Shqipërisë vazhdon të derdhet gjak dhe të ketë një numër kaq të madh viktimash? Në disa nene, ku shpreheni për gjobat, keni vendosur gjoba të cilat variojnë nga një vlerë në një vlerë tjetër. Dhe kjo lë një shteg për të abuzuar. Nuk mund të vendosësh gjoba nga 10 mijë lekë në 40 mijë lekë, ndërkohë që mund të jetë taksative për të qenë më konkrete.

Megjithatë, zoti kryetar, kjo pikë mund të konsultohet dhe drejtpërdrejt kur të flasim nen për nen.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj - Faleminderit, zoti Qefalia!

Zotërinjtë e ministrisë.

Maksim Tashi – Siç e thamë edhe më lart, baza dhe kryesorja është direktiva 126, por dhe në detyrat që ka marrë Komiteti Ndërmintor i Sigurisë Rrugore ka disa ndryshime. Disa porosi që kanë ardhur nga Brukseli, për aksidentet e fëmijëve, në aspektin e pajisjes së mjetit me mbajtëset e fëmijëve, me një fjalë janë një kompleks gjërash që janë bërë. Ndryshimet janë bërë në dhjetor të 2011-s dhe kjo direktivë nuk kishte hyrë në fuqi. Në kompleks janë 3-4 arsye, jo thjesht direktiva 126, Direktiva e Lejes së Drejtimit. Peshën më të madhe e ka 126.

Lidhur me dhjetëfishimin e gjobave, gjobat që janë rritur me ndryshimet e kaluara kanë qenë thjesht për aksidentet ose si të thuash shkelje që reflektoheshin me aksidente. Kurse gjobat që ndryshojmë ne janë për ata persona të cilët dëmtojnë sinjalistikën rrugore, që indirekt sjellin dhe pasoja me aksident. Mungesa e sinjalistikës nga vjedhjet është një ndër shkaqet kryesore. Janë të evidentuara të gjitha shkeljet. Zhdëmtimet që kemi bërë te neni 2 dhe rritja e masës së gjobave me dhjetëfish për ata që dëmtojnë rrugën, në kompleks, do të sjellë efekte goxha pozitive në aksidente. Ky është mendimi i ekspertëve të rrugëve dhe i Ministrisë së Transportit.

Për sa i përket tarifave fikse, me sa mbaj mend, edhe herës tjetër është diskutuar dhe nuk lejohet më tarifa fikse, gjoba fikse. Për mosvendosje rripi mund të gjobitet edhe një deputet, pavarësisht se mund të ketë një hall apo shqetësim.

Fatmir Xhafaj – Në Shqipëri janë 140 deputetë, shqiptarë janë 3 milionë. Se e keni mësuar edhe ju edhe Ministria e Brendshme, deputeti është deputet.

Maksim Tashi – Një punonjës ose një drejtor pasi del nga një mbledhje është i stresuar...

Fatmir Xhafaj – Ligji bëhet për qytetarët, nuk bëhet as për deputetët, as për drejtorët, as për ju, as për mua.

Maksim Tashi – Një qytetar që ka një arsye të fortë dhe për momentin nuk e ka mendjen, nuk e vendos rripin, polici e shikon të arsyeshme për ta gjobitur me taksën minimale. Në autostradë nuk lejohet në mënyrë kategorike mosvënia e rripit.

Fatmir Xhafaj –Faleminderit, zoti Tashi!

Zonja Hysi e keni fjalën.

Vasilika Hysi - Faleminderit!

Faleminderit, përfaqësuesve të Ministrisë së Transporteve!

Unë kam dy pyetje. Pyetja e parë ka të bëjë me paketën e ndryshimeve që ju sillni. Ky është një ligj që kalon me shumicë të cilësuar dhe ne para 2 vjetësh kemi bërë ndryshime në ligj. Unë kam pyetur ministrin e asaj kohe nëse ka nevojë për ndryshime të tjera dhe më ka thënë se këto janë ndryshimet më të nevojshme. Ndërkohë që ju sot sillni këto ndryshime dhe i referoheni një direktive të BE-së që daton në 2006-n. Cila është arsyeja që ju i paraqisni tashmë këto ndryshime kur direktiva ka qenë në atë kohë?

Pyetja e dytë ka të bëjë me faktin nëse a ka nevojë për ndryshime të tjera në Kodin Rrugor? Pra, prisni që ne të ndërhyjmë, të bëjmë përsëri arnime në këtë ligj të cilësuar? A keni bërë konsultime me grupet e interesit, përveç Shoqatës së Autoshkollave, që e keni vënë në dukje edhe në relacion që jeni konsultuar lidhur, sidomos me nenin 10 dhe nenin 11? Pra, sa mbahen parasysh grupet e tjera të interesit?

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Ju lutem përfaqësuesve të ministrisë të japin përgjigje për dy pyetjet e koleges.

Zoti Tashi.

Maksim Tashi - Ndryshimet që janë propozuar në 2011-n kanë qenë pa hyrë në fuqi kjo direktivë. Ndryshimet që ne kemi reflektuar në atë kohë nuk kanë qenë lidhur me këtë direktivë, por kanë qenë sipas propozimeve të Ministrisë së Brendshme për katërfishimin e gjobave. Në kuadrin e ndryshimeve u përmirësuan, edhe me disa ndryshime të opozitës së asaj

kohe, dhe u reflektuan në ndryshimet e Kodit. Në atë kohë është bërë pyetja nga ju, dhe përgjigja është kthyer që “Për momentin nuk ka më ndryshime”.

Tanin jemi në vitin 2014. Kjo direktivë në vitin 2013 ka hyrë në fuqi për vendet e BE-së. Me të vërtetë është direktivë e vitit 2006, por po të shikosh në nenin 2, në datën 13 janar të vitit 2013 fillon aplikimi për vendet e BE-së.

Ndërsa për pyetjen e dytë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ja, ta thotë juristi.

Eni Culli – Përsëritje!

Atëherë, mendoj se, si çdo ligj tjetër, edhe Kodi Rrugor është një ligj, pavarësisht se është ligj i cilësuar, që kërkon një kuorum të caktuar në votim, kërkon aplikime, ndryshime, përditësime jo shumë të shpeshta, për shkak se është kod rrugor dhe nuk preket shumë shpesh, por mendojmë se do të ketë ndryshime të tjera dhe mendojmë të bëhet një Kod i ri Rrugor. Por këto ndryshime duheshin bërë në mënyrë sa më të shpejtë për uljen e numrit të aksidenteve, si dhe në kuadër të Komitetit Ndërmintor për Sigurinë Rrugore duheshin marrë këto masa. Është një plan që mund të jetë 2-vjeçar apo 3-vjeçar për të bërë një Kod të ri Rrugor pasi arnimet e herëpashershme kërkojnë ndoshta një Kod të ri Rrugor me asistencën e Bashkimit Europian dhe gjithë grupeve të interesit, që janë të interesuar, janë ekspertë në fushën e sigurisë rrugore dhe të qarkullimit rrugor.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Vasilika Hysi – Po konsultime keni bërë?

Eni Culli – Edhe konsultime kemi bërë me të gjithë, me Shoqatën e Autoshkollave, me institucionet që janë pjesë e Kodit Rrugor, me Policinë Rrugore, me Ministrinë e Brendshme kemi qenë çdo hap për ndryshimin. Për çdo person që ka qenë i interesuar Ministria e Transportit ka qenë e hapur për çdo pyetje apo dhe sugjerime në *e-mail* për ndryshimet e Kodit Rrugor.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Rroftë *email*-i.

Zoti Qefalia, përsëri një pyetje, ju lutem!

Xhemal Qefalia – Unë doja t’ju pyesja drejtpërdrejt: a ka ndonjë direktivë tjetër që hyn në fuqi në vitin 2015-2016? Që ta ezaurojmë tani, të mos presim që të jemi të vonuar.

Fatmir Xhafaj - Një minutë, se kur jep ... të dhëna polici juaj, merr gjobë, apo jo?

Maksim Tashi – Kemi dhe një direktivë tjetër të lejes së qarkullimit, por që nuk ka lidhje me Kodin, është kompetencë e ministrit...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Me Kodin nuk ka. Me Kodin e mbyllim.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Ok. Faleminderit!

Ka pyetje të tjera?

Kam unë një pyetje. Siç e trajtoi edhe zonja Hysi, u përpoqët ta sqaronit edhe ju në përgjigjet tuaja, ka pasur një ndryshim në vitin 2011 lidhur me Kodin Rrugor dhe në këtë komision është bërë një debat jo i rëndësishëm, që ka marrë edhe kohë për disa çështje të rëndësishme, edhe sepse në logjikën tonë ndryshimi në një kod nuk është një gjë e zakonshme dhe duhet vlerësuar seriozisht për iniciuesit e nismave të tilla. Një nga pikat më të nxehta të atij debati ka qenë dyfishimi dhe trefishimi i gjobave. Sot unë dua të pyes: a ka një analizë nga ministria juaj në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme, për efektin e këtyre masave që ne kemi marrë? Sepse një ligj është i mirë kur zbatohet në praktikë, jo kur është një ligj që arkivohet në arkiv. Dhe ne si ligjvënës duam të dimë, dhe kjo është absolutisht në përgjegjësinë dhe detyrën tonë, ato ndryshime për të cilat ne kemi diskutuar, debatuar dhe më në fund kemi votuar, çfarë efekti kanë sjellë? Pra, pas vitit 2011, duke i marrë nen për nen ato, 2012, 2013, 2014, cilat janë efektet që kemi sot? Keni ju një analizë të tillë? E para. Nëse e keni, pa dyshim, që të mos e përsëris veten, do të ishte mirë ta vendosim në dispozicion të debatit që do të bëjë komisioni nen për nen.

E dyta që kam unë, ka të bëjë me faktin që në këtë proces, lidhur me Kodin Rrugor, përfshihen një sërë agjencish ekzekutive, dy nga të cilat më kryesore janë ministria që përfaqësoni ju dhe Ministria e Brendshme, por dhe agjenci të tjera. Por të mos harrojmë që ka një sërë subjektesh të tjera të përfaqësuesve të grupeve të interesit, të cilat, gjithashtu, kanë rol të rëndësishëm në këtë proces. Ne do të deshëm të dinim, në vazhdim të pyetjes së koleges Hysi, se cilat ka qenë konsultat e drejtpërdrejta, përveç *email*-it tuaj, *facebook*-ut dhe ku e di unë se çfarë, (ok, edhe këto janë instrumente që duhet të përdoren dhe të përdoren mirë), por problemi

është në tavolina, tryeza, konsulta dhe, gjithashtu, në përmbyllje të përgjigjes tuaj ne do të dëshironim të na vendosnit në dispozicion një përmbledhje të çështjeve që janë trajtuar në këto praktika dhe në këto tryeza, në mënyrë që t'i mbajmë në konsideratë për të parë sa janë reflektuar në këtë kod. Ministria duhet ta mirëkuptojë gjithë këtë debat dhe duhet të jetë gjithashtu bashkëpunuese në këtë proces, sepse këtu nuk bëhet fjalë thjesht për të ndryshuar Kodin Rrugor, por bëhet fjalë për t'u dhënë më shumë siguri qytetarëve në rrugët e Shqipërisë, një gangrenë shumëvjeçare në këtë vend që ka një pasojë të rëndë, shumë të rëndë: jetën e njerëzve. Prandaj ne së bashku nuk mund dhe nuk duhet ta kalojmë këtë si një amendim të zakonshëm, por si një përgjegjësi për të siguruar jetën e qytetarëve tanë.

Kështu që, në këtë kontekst, do të dëshiroja më shumë angazhim dhe më shumë përgjegjësi edhe nga ana juaj, jo vetëm sot, por edhe në vazhdim.

Kush mund të përgjigjet për këto pyetje?

Zoti Tashi, urdhëroni!

Maksim Tashi – Lidhur me efektet e propozimit për gjobat dhe në kuadër të kryerjes së detyrave të tjera, nuk mund ta marrim thjesht dhe vetëm për efekt të gjobave, për këtë vit numri i aksidenteve me pasojë vdekjen, deri në fund të vitit, në krahasim me vitin 2013, parashikohet dhe besoj me 99.9% do të realizohet, që masa e aksidenteve me vdekje do të ulet rreth 20 %.

Fatmir Xhafaj – Pse keni filluar t'i parashikoni vdekjet në rrugë?

Maksim Tashi – Po, sepse ne çdo muaj, në bashkëpunim me Policinë Rrugore, kemi grafikisht aksidentet me pasojë vdekjet të çdo muaji dhe të çdo viti, dhe deri tani jemi 23 % më pak se sa vjet për këtë periudhë. Muaji dhjetor ka pak më shumë se vijnë emigrantët dhe themi që viti 2014 do të ketë rreth 20 % vdekje më pak se sa viti 2013.

Fatmir Xhafaj – Dhe ju jeni shumë i kënaqur...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në qoftë se ju do të bëni dhe rolin e agjencive funerale, kjo mund të ishte....

Dakord.

Maksim Tashi – Tani ju...

Fatmir Xhafaj – Ne për këtë jemi, që edhe një njeriu po t'i cenohet jeta, jemi të shqetësuar, jo kur janë 23 % më pak, apo 10 % më pak.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, zoti Tashi, urdhëroni!

Maksim Tashi – Lidhur me agjencitë e tjera të interesuara më ndryshimet e Kodit.

Fatmir Xhafaj – Jo, pyetja ime është më e thjeshtë sesa e komplikuar ju. Keni një analizë?

Maksim Tashi – Kemi.

Fatmir Xhafaj – Do të na e sillni atë analizë në dispozicion?

Maksim Tashi – Po.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Maksim Tashi – Lidhur me agjencitë e tjera që preken nga Kodi Rrugor ne faktikisht kontaktojmë në vazhdimësi me to. Po marrim, për shembull, koncesionarët e mjeteve të reja. Me këta kemi kontaktuar, dhe është bërë edhe një grup pune në bashkëpunim me Ministrinë e Zhvillimit të Ekonomisë dhe Tregtisë për të njëjtin shqetësim që ngriti deputeti, për mjetet me timon në krah të kundërt. Koncesionarët e Shqipërisë do të pengohen që këto lloj mjeteve t'i fusin në Shqipëri.

Shqetësimi i dytë i tyre ishte për pengimin e mjeteve të vjetra dhe futjen në Shqipëri të mjeteve EURO V. Nga disa shoqëri të tjera ka pasur shqetësim që mjetet, përpara se të hyjnë në Shqipëri, të kontrollohen nga këto koncesionare ose nga subjektet e licencuara nga Ministria e Transportit. Me një fjalë, janë një sërë shqetësimesh që janë ngritur pranë ministrisë dhe ne i kemi në proces. Por në këto ndryshime të Kodit kemi menduar dhe e kemi parë të arsyeshme që të mos jenë pjesë e tyre. Ka pasur shqetësime edhe për verifikimin e aftësive fizike dhe mendore të kandidatëve për drejtues mjeti, që të mos jenë vetëm subjektet ose mjekët e lagjeve që kemi ne, por të ketë edhe subjekte të licencuara për verifikimin e aftësive fizike dhe psikike të këtyre. Kjo është diçka që e kemi reflektuar, kemi pasur shqetësimin e autoshkollave që asnjë mjet i autoshkollës të mos jetë me qira po të jetë në pronësi të autoshkollës dhe ndryshimet konstruktive që bëhen, të bëhen vetëm për subjekte që janë në pronësi të autoshkollës. Këtë e kemi reflektuar. Shoqata “Autoshkolla” donte të vinte sot, por nuk ishte pjesë. Nuk mund të merrnim ne përsipër që ata të vinin dhe të mbronin shqetësimin tyre. Megjithatë, kur të shqyrtohet nen për nen, do t'ju paraqesim me të shkruar shqetësimet tuaja.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Dakord. A ka pyetje të tjera? Nuk ka pyetje të tjera. A ka diskutime? Nuk ka diskutime.

E mbyllim këtu në parim, duke qenë dakord, siç e parashtroi relatori, për ta votuar në parim dhe për të hapur pastaj debatin nën për nën.

Relatorët do të duhet të na bëjnë me dije nëse do të ketë nevojë që përpara votimit nën për nën të dëgjojmë grupet e interesit. Është e mjaftueshme deri nëse t'i njoftojmë, nëse do të jetë e nevojshme.

Faleminderit!

Shpresoj të jemi mirëkuptuar për çfarë ju kërkuam dhe kryesorja është një angazhim më i madh që duhet në diskutimin e këtij akti.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 15.10.2014, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Armando Subashi, Bashkim Fino, Ulsi Manja, Xhemal Qefalia, Dashamir Peza, Blendi Klosi, Armando Prenga, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Piro Lutaj, Tahir Muhedini, Petrit Vasili, Vexhi Muçmataj, Nard Ndoka, Mark Frroku, Tom Doshi dhe Silva Caka.

Mungojnë:

Mhill Fufi, Eduard Halimi, Oerd Bylykbashi, Spartak Braho, Edi Paloka, Gent Strazimiri, Arben Ristani, Keltis Kruja, Kastriot Islami, Gjovalin Bzheta dhe Fatmir Mediu.

Të ftuar:

Wolfgang Rusch – ekspert i SIGMA-s

Migena Kondo – përkthyesë

Agnes Bernhard – zëvendësues i Misionit EURALIUS

Koço Bendo – përfaqësues nga EURALIUS

Fatmir Xhafaj - Fillojmë me pikën tjetër të rendit të ditës. Siç jeni njoftuar dhe siç jeni në dijeni edhe nga kalendari, sot kemi në shqyrtim projektligjin “Për Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Është e njohur për kolegët, për medien dhe publikun fakti që këtë projektligj e kemi shqyrtuar në parim.

Kemi bërë një diskutim në parim, e kemi votuar, gjithashtu, në parim duke e konsideruar një dokument shumë të rëndësishëm, një projektligj shumë të rëndësishëm. Me shumë të drejtë mund ta konsiderojmë edhe si kushtetuta e veprimit të administratës publike, por edhe e gjykimit administrativ. Kjo është arsyeja që ne ashtu si edhe iniciuesit e këtij projekti, Ministria e Drejtësisë, i kemi dhënë të gjithë kohën e nevojshme shqyrtimit të këtij projektligji të rëndësishëm, sepse nuk është qëllimi të mund të bëjmë një ligj më shumë, por është shumë e rëndësishme të bëjmë një ligj të mirë, që t’i qëndrojë kohës.

Gjithashtu, është i njohur për të gjithë fakti që në këtë proces janë involvuar në mënyrë aktive strukturat e ekspertizës së Bashkimit European dhe posaçërisht Misioni SIGMA, i cili ka caktuar një ekspert të njohur në këtë fushë, zotin Wolfgang Rusch, i cili ka punuar ngushtësisht me ministrinë dhe me ekspertët e angazhuar nga ministria për ta përmirësuar cilësisht draftin.

Zoti Rusch është prezent në këtë mbledhje të komisionit për t’u dëgjuar për disa çështje thelbësore të projektit.

Unë dëshiroj ta falënderoj atë edhe në emër të kolegëve për kontributin e përbashkët me ekspertët shqiptarë duke shpresuar që do të jetë bashkë kontribuues edhe në vijim me Ministrinë e Drejtësisë dhe ekspertët që komisioni dhe pastaj parlamenti të votojë një ligj që do të jetë cilësor në kushtet e vendit tonë.

Gjithashtu, e pranishme në këtë mbledhje komisioni është edhe zonja Agnes Bernhard, zëvendësshefe e Misionit EURALIUS së bashku me përfaqësuesit e tjerë të misionit.

Ju jeni në dijeni të faktit që më 1 shtator ka filluar Misioni EURALIUS -4 në Shqipëri, një mision asistence i Bashkimit European. Ne shpresojmë që ky mision të jetë, gjithashtu, një vlerë më shumë në përpjekjet që po bëhen për përmirësimin e sistemit të drejtësisë në Shqipëri dhe jemi besimplotë me përbërjen që ka misioni se do të jetë i suksesshëm, por, meqenëse është hera e parë që një përfaqësues i Misionit EURALIUS të BE-së është i pranishëm në komision, dëshiroj që t’i uroj mirëseardhjen.

Suksese në detyrën tuaj! Ne në Shqipëri kemi një shprehje: “Me këmbë të mbarë!”

Do të dëgjojmë zotin Rusch për të bërë një përmbledhje të shkurtër. Do të preferonim çështjet kyçe të projektligjit, por më shumë çështjet që janë të diskutueshme dhe që kërkojnë vendimmarrjen tonë, pa hyrë në detaje, sepse ato janë të njohura gjerësisht nga kolegët dhe koha që kanë kolegët në dispozicion e mundëson këtë, një njohje për çështjet që kanë nevojë për debat dhe diskutim të mëtejshëm.

Nëse ministria do të ketë nevojë për ndonjë ndërhyrje, mund ta bëjë.

Fjala për zotin Rusch.

Wolfgang Rusch –Përshëndetje të gjithëve!

I nderuar zoti kryetar i Komisionit të Ligjeve të Republikës së Shqipërisë, të nderuar anëtarë të Komisionit të Ligjeve,

Në radhë të parë doja t’ju falënderoja për ftesën dhe për mundësinë që kam për të dhënë kontributin tim në shqyrtimin e këtij akti ligjor, të këtij Kodi të Procedurave Administrative, i cili është tejet i rëndësishëm dhe, siç ju shumë mirë e quajtet, mund të konsiderohet si kushtetuta e administratës publike, e praktikës së administratës publike, por ka edhe një rëndësi tjetër shumë të veçantë, sepse është një pjesë e legjislacionit, e cila është e lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me jetën e qytetarëve që nga momentin që ata lindin dhe përgjatë të gjithë jetës së tyre, në ndryshim nga pjesë të tjera të legjislacionit, siç është e drejta penale apo dispozitat e të drejtës kontraktore, të cilat nuk është se njerëzit i hasin në mënyrë të detyrueshme në jetën e tyre të përditshme.

Ky është një kod shumë i rëndësishëm edhe për cilësinë dhe për marrëdhënien që ka me qytetarët, me administratën publike. Dua të theksoj gjithashtu se SIGMA si organizatë ka krijuar bashkëpunim me Shqipërinë që në vitin 1999 dhe në këtë mënyrë ajo ka marrë shumë informacion dhe ka krijuar shumë eksperiencë për sa i takon veçantive të vendit të huaj, rrethanave, situatës në Shqipëri.

Një veçanti dhe një filozofi tjetër e organizatës së SIGMA-s është që ndryshe nga organizata të tjera ndërkombëtare që japin konsulentë apo këshillim në vendet në zhvillim, në vendet si Shqipëria, përpiqet që të mos transferojë në mënyrë shabllon ekspertizë nga vendet e tjera, nga kontekste të vendeve të tjera, por gjithmonë ta përshtatë ekspertizën dhe këshillimin e saj bazuar në rrethanat dhe në kontekstin lokal dhe të Shqipërisë në këtë rast.

Gjithashtu, SIGMA është shumë krenare që ne kemi përmbushur tashmë 15 vjet bashkëpunim me Shqipërinë dhe ky është një tregues shumë i qartë edhe i besimit që keni ju në organizatën tonë.

Që në vitin 2007, qeveria e Republikës së Shqipërisë i kërkoi SIGMA-s që të bënin një vlerësim të Kodit, që ishte miratuar përpara tetë vjetve. Kjo për arsye, sepse Kodi i Procedurave Administrative, që është miratuar në vitin 1999, po shfaqte disa problematika për sa i takonte zbatueshmërisë së tij në jetën e përditshme.

Në atë kohë SIGMA ngarkoi një ekspert italian, i cili ishte nga bota akademike, në fushën e së drejtës administrative dhe një ish-praktikues, një kryebashkiak të Gjermanisë, të cilët bënë një vlerësim të kodit, duke nxjerrë disa komente lidhur me situatën. Kështu që në fund të vitit 2008, u krijua një grup pune me ekspertë të mirënjohur shqiptarë për rishikimin e Kodit të Procedurës Administrative. Ata u asistuan nga ekspertë ndërkombëtarë italianë, spanjollë, holandez dhe gjerman, të cilët në fund të punës së tyre nxorën një dokument politikash, i cili propozonte që të kishte një kod të ri të procedurës administrative, për arsye se ishte më e lehtë dhe konsiderohej më e lehtë që të kishte një kod të ri, në qoftë se dëshirohej të bëheshin ndryshime thelbësore të tij, sesa të bëheshin amendamente në kodin ekzistues.

Ajo që u konkludua dhe u vendos në fund të vitit 2008 nga Ministria e Drejtësisë ishte që të kishte një kod të ri të procedurës administrative, i cili do të ishte në përputhje me parimet dhe standardet e Bashkimit European, parimet e praktikës administrative në vendet e Bashkimit European.

Dua të theksoj se qëllimi primar nuk ishte që ky kod thjesht të ishte në përputhje me standardet e Bashkimit European. Qëllimi ishte që të gjitha dispozitat e zgjidhjes që do të propozonte ky kod i ri të ishin më të përshtatshmet dhe më të mirat për vendin tuaj, ndërkohë që praktikat më të mira dhe më të suksesshme në Bashkimin European të shërbenin si udhëheqës për hartimin e këtij kodi.

Pra, dua të theksoj se nuk ishte Karta Europiane që shërbente si një udhëheqës kryesor i këtij procesi, por gjetja e zgjedhjeve më të mira që do t'i përshtateshin kontekstit shqiptar në hartimin e këtij ligji. Kështu që në vitin 2011 u arrit që të paraqitej te Ministria e Drejtësisë një tekst i plotë i Kodit të ri të Procedurave Administrative dhe ky draftkod ishte pikënisja mbi të cilën u punua dhe vazhdoi procesi i konsultimeve në të cilin u përfshi edhe SIGMA, që vazhdoi deri në prill të vitit 2013. Por procesi lëvizti realisht pas verës së 2013-ës dhe ne ishim shumë të

kënaqur për këtë hap. Në fillim të vitit 2014, në janar, Ministria e Drejtësisë nisi procesin e konsultimeve publike, gjatë të cilit u kryen shumë konsultime me publikun dhe aktorët e interesuar.

Në janar të vitit 2014 SIGMA-s ju kërkua që të bënte vlerësimin e variantit të kodit. Pas vlerësimit rezultoi se kodi ishte shumë i mirë, ishte në përputhje me standardet ligjore të Bashkimit Europian, ishte në përputhje me direktivat që në këtë aspekt duhet të transponohen në të ardhmen. Pra, ishte një rezultat shumë i mirë i vlerësimit. Më pas ai kaloi në procesin e konsultimeve publike. Ndërkohë që periudha që vijoi në një farë mënyre kishte njëfarë presioni kohor dhe ky nxitim është shumë i justifikuar, sepse ky ishte një proces që kishte filluar prej shumë vitesh, kështu që vullneti politik ishte aty dhe ne e kuptojmë që ky ishte një hap pozitiv dhe kishte një qëllim shumë pozitiv, por nga ana tjetër kishte shumë pak kohë në dispozicion për të bërë një vlerësim të detajuar e të kujdesshëm të të gjitha propozimeve dhe ndryshimeve që u propozuan gjatë procesit të konsultimeve. Dhe këto komente ishin të shumta.

Ajo që ndodhi më pas është se Ministria e Drejtësisë e përfundoi procesin, sa i takon qeverisë, dhe ia paraqiti atë Kuvendit, ndërkohë që SIGMA-s iu kërkua të bënte një vlerësim të këtij varianti, të draftit të rishikuar nga konsultimet në fund të korrikut të vitit 2014.

Pra, për ta përmbledhur, ajo që ndodhi është se ne punuam paralel, ndërkohë që drafti përfundimtar me komentet e konsultimeve u paraqit nga Ministria e Drejtësisë te Kuvendi. Ndërkohë, Ministria e Drejtësisë së bashku me asistencën e SIGMA-s punuan për të vlerësuar të gjitha ato komente që ishin shtuar gjatë procesit të konsultimeve publike.

Ne patëm diskutime shumë të zjarra, shumë intensive me Ministrinë e Drejtësisë, me përfaqësuesit e SIGMA-s, dhe kjo është normale. Në përfundim të diskutimeve tona nxorëm një listë të atyre komenteve e sugjerimeve që ne bëmë, mbështetur mbi komentet që i ishin bërë draftit nga konsultimet publike, për të cilat ramë dakord me Ministrinë e Drejtësisë.

Të gjitha këto pika, për të cilat ne ramë dakord gjatë diskutimeve e vlerësimit që i bëmë draftit me komentet e konsultimet publike, i kemi përmbledhur në një dokument me komente, të cilat Ministria e Drejtësisë ia ka paraqitur Kuvendit. Ne do të vlerësonim shumë që këto komentet tona të merreshin parasysh gjatë vlerësimit nën për nen që do t'i bëhet kodit në Komisionin e Ligjeve. Këto komentet tona nuk kanë mbaruar. Ne do t'ju dërgojmë edhe një pjesë tjetër, përfundimtare, të komenteve tona, të cilat do t'i merrni në fund të kësaj jave të përgatitura nga Ministria e Drejtësisë.

Ndërkohë, para se unë t'ju lë mundësinë të më drejtoni ndonjë pyetje, në qoftë se keni, do të doja të bëja komentin e fundit: në qoftë se gjatë punimeve për shqyrtimin e këtij drafti ju do të keni nevojë asistencën e SIGMA-s, së bashku me Ministrinë e Drejtësisë ne mund t'ju asistojmë përgjatë gjithë procesit, për të dhënë edhe shpjegime të mëtejshme për ato komente që ne kemi bërë dhe që jua kemi paraqitur mbi versionin që ju keni marrë pas konsultimeve publike të kodit.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Rusch!

A ka Ministria ndonjë koment, përpara se të bëjmë ndonjë pyetje? Nëse ka.

Edlira Jorgaqi - Në fakt nuk është se kam koment. Zoti Rusch i shpjegoi me detaje. Është produkt i një pune të lodhshme, do të thosha, në Ministrinë e Drejtësisë për përgatitjen e këtij akti tejet të rëndësishëm. Thjesht do të doja të theksoja edhe një herë procesin e konsultimit e të vlerësimit të mendimeve të ardhura në Ministrinë e Drejtësisë, konsultimin e këtij projekt-akti; duke parë gjithnjë rëndësinë e madhe që ka, u publikua në faqen e internetit, duke i bërë thirrje kujtdo që ka ekspertizën e duhur për të përmirësuar sadopak këtë akt. U organizuan tavolina të rrumbullakëta me ekspertë të fushës, gjë të cilën dua ta theksoj edhe një herë, që drafti që ju keni përpara, projekti që ju keni përpara, reflekton realisht mendimet dhe ekspertizën e ekspertëve të së drejtës administrative, më të mirën në vend, si dhe të akademikëve e të praktikantëve, pra të atyre do ta zbatojnë në praktikë këtë kod. Sigurisht, jemi në proces. Kemi qenë gjatë kësaj kohe në bashkëpunim të ngushtë edhe me ekspertët e SIGMA-s, me zotin Rusch, për të përmirësuar e kontribuar sadopak në këtë akt kaq të rëndësishëm gjatë procesit të shqyrtimit nen për nen pranë këtij komisioni.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit për ndërhyrjen tuaj, zonja Jorgaqi!

Përfaqësuesit e misionit EURALIUS nuk kanë ndonjë koment, besoj. Në rregull. Janë thjesht për ta ndjekur, për ta vëzhguar.

Kam unë një pyetje, ose më saktë, do të dëshiroja të sqarohesha. Ky është një proces që, me sa kuptova edhe nga ana juaj, edhe nga përmbledhja që ka paraqitur relacioni i Ministrisë, ka rreth gjashtë vjet që diskutohet. Gjithashtu, keni një vit që diskutoni me ekipin e ri të Ministrisë së Drejtësisë. Ndërkohë që ligji vjen në parlament, ju vazhdoni diskutimet dhe vetëm në minutat

e takimit të shtatorit, që kam lexuar, ka rreth njëzet e pesë nene të diskutuara e të ndryshuara nga drafti që ka ardhur në parlament.

Tani unë nuk e kuptoj: përse duhet të bëhet ky proces, që faktikisht është bërë në kohë, para se të vijë në qeveri dhe para se të vijë në parlament? Sepse komisioni nuk mund të marrë rolin e Ministrisë së Drejtësisë dhe as Ministria e Drejtësisë nuk mund të luajë rolin e komisionit. Janë komplementarë në qëllimin për të bërë ligjin, për një ligjbërje cilësore, por secili në detyrën e vet. Në këndvështrimin tuaj, ku qëndron problemi?

Këtë përgjigje e dua edhe për të organizuar punën më pas, por edhe si përvojë për projektet e nesërme.

Wolfgang Rusch – Atëherë, për ta përmbledhur, arsyeja për këtë qasje të pazakontë të procesit, është se iu dha rëndësi e madhe shpejtësisë së procesit, përshpejtimit të procesit, ndërkohë që duhet të kemi parasysh se cilësia është më e rëndësishme se koha në këto raste. Ndërkohë që në korrik të 2014-ës drafti i ishte paraqitur Kuvendit, ne e kuptuam dhe konstatuam se kish pasur shumë komente, të cilat qenë shtuar gjatë procesit të konsultimeve publike, të cilat nuk ishin në përputhje me vetë draftin përfundimtar të janarit 2014; nuk përputheshin si nga forma, ashtu edhe nga përmbajtja e tyre.

Duke pasur parasysh edhe periudhën, se ishte periudhë vere, korrik-gusht, nuk ishte shumë e mundur që njerëzit të ishin të disponueshëm, pati edhe disa faktorë të tjerë që ndikuan:

Faktori i parë influencues ishte qëllimi i mirë i Ministrisë së Drejtësisë që të përfshinte komentet që ishin bërë nga palët e interesuara në mënyrë sa më origjinale.

Faktori i dytë që e influencoi këtë gjë ishte ai i nxitimit dhe i dëshirës për ta paraqitur draftin në Kuvend përpara pushimeve verore. Kjo për presionin ndërkombëtar, për detyrimet ndërkombëtare, për reformat etj.

Faktori i tretë influencues, që ishte konfliktues me dy të parët, ishte edhe nevoja për të bërë një harmonizim dhe një përshtatje të gjithë këtyre komenteve që i ishin bërë draftit nga konsultimet publike, të cilat nuk mund të realizohen në mënyrë cilësore në një periudhë dhe në një kohë kaq të kufizuar.

Fakti që Komisioni i Ligjeve ka pranuar këto dokumente me komentet që ne kemi bërë, për të përmirësuar të gjitha këto ndryshime që i janë bërë kodit gjatë konsultimeve publike, është një shenjë e mirë dhe na jep neve shpresë dhe besim se do të merren parasysh gjatë shqyrtimit nën për nen të këtij draftkodi.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

A ka ndonjë pyetje tjetër?

Zonja Hysi, keni fjalën.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Falënderoj ekspertin dhe i uroj mirëseardhjen përfaqësueses së EURALIUS-it në komisionin tonë!

Unë kam një pyetje, e cila më ka shqetësuar sa herë që diskutojmë ligje që bëhen me asistencën ndërkombëtare.

Bëhet fjalë për tri ligjet që ne kemi kaluar në Kuvend: ligjin për nëpunësin civil, ligjin për administratën shtetërore dhe Kodin e Procedurave Administrative, po të shtojmë këtu Gjykatën Administrative dhe kodin që është në diskutim. Projekti që ne kemi në dorë sa i mban parasysh tri ligjet e miratuara në Kuvend jo më larg, por dy vjet më parë?

Pyetja e dytë, ju e thatë mirë që ka pasur nxitim, sa ky ligj, bashkë me komentet që do të paraqisni, mban parasysh faktin që do të jetë i qëndrueshëm për vite të tëra? Më vjen keq që po them, të më falë edhe kryetari që po bëj një koment, por ne po ndryshojmë ligje me shumicë të cilësuar pa mbushur ende një periudhë dhe nuk e kemi provuar efektin e tyre. Kjo kërkohet gjithmonë nga BE-ja dhe nga misionet që operojnë në Shqipëri. Ndërkohë që në vendin tuaj besoj se ligjet kanë një jetëgjatësi shumë më të madhe.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zonja Hysi!

Zoti Rusch mund të na jepni një përgjigje prej eksperti.

Wolfgang Rusch – Shumë faleminderit për pyetjet, ato janë me spec dhe unë jam shumë i lumtur që ju i bëtë!

Është e vërtetë që në Shqipëri këto tri ligje që ju përmendët janë hartuar me asistencën e ekspertëve ndërkombëtarë, por dua të theksoj se tashmë Shqipëria nuk është më në atë fazën e emergjencës së miratimit të ligjeve, nuk është më në fazën e tranzicionit. Shqipëria mund të konsiderohet si e integruar në familjen europiane dhe që i përqafton standardet europiane. Edhe në vendet e BE-së shumë ligje të rëndësishme miratohen me përfshirjen e ekspertëve të huaj të vendeve fqinje apo vendeve të tjera të BE-së. Mund t'ju jap një shembull konkret, në Gjermani ne kur miratuam ligjin e procedurave administrative na u desh të përfshinim edhe direktivën europiane të shërbimeve. Për këtë ligj ne nuk kishim ekspertizë dhe në këtë proces përfshimë

edhe ekspertë nga Holanda, Portugalia apo vendet e tjera. Kështu që Shqipëria nuk është më në fazën e tranzicionit, por në një moment tjetër dhe ka një qasje tjetër ndaj asistencës ndërkombëtare.

Për sa i takon pyetjes së dytë, është e vërtetë që këto tri ligje janë shumë të ndërlidhur me njëri-tjetrin, janë shumë kryesorë për administratën publike, prandaj u vendos që të hartohesh një kod totalisht i ri Procedurave Administrative në vitin 2008, në një moment kur ligji për gjykimin administrativ i ishte paraqitur Kuvendit, në mënyrë që ne të realizonim një harmonizim sa më të mirë ndërmjet këtyre dy ligjeve.

Për sa i takon çështjes së tretë, qëndrueshmërisë së ligjeve, jetëgjatësisë së tyre, ky është një problem jo vetëm shqiptar, por tashmë, me zhvillimin e shoqërive tona, po bëhet problem edhe në vendet tona. Ka një prodhim masiv të ligjeve, kurbat rriten në mënyrë shumë të shpejtë edhe në Gjermani, veçanërisht për sa u takon aspekteve të ndryshimeve të shpeshta që po ndodhin në shoqëritë tona, si teknologjia e informacionit, mënyra sesi shkëmbehet informacioni etj. Kështu që ne presim të kemi më shumë ndryshime në të ardhmen dhe më shumë ligje. Besoj se për këtë arsye jetëgjatësia e ligjeve edhe në botë ka filluar të jetë më e shkurtër se ndoshta 30 vjet më parë. Megjithatë, fakti që ky proces ka zgjatur 6 vjet mendoj se është një ogur i mirë dhe është një shpresë për ne, se ai ka arritur të prodhojë një draft, një dokument cilësor dhe do të ketë më shumë një jetëgjatësi sesa kodet e mëparshme.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Zonja Jorgaqi, kishit koment? Ju lutem, shumë shkurt, sepse koha e përcaktuar prej meje po shkon në limit.

Edlira Jorgaqi – Unë do të vazhdoj atë që sapo përfundoi zoti Rusch, duke thënë që puna në Ministrinë e Drejtësisë për hartimin e këtij projektakti është mbështetur në dy parime tejet të rëndësishme, që lidhen së pari me ndotjen legjislative dhe me konfuzionin legjislativ, të cilat çojnë te përgjigjet e pyetjeve që ju ngritët, zonja Hysi. Ju garantoj se Ministria e Drejtësisë, mbështetur në këto parime, është përpjekur të paraqesë një projektligj që është i harmonizuar edhe me ligjet e tjera që ju përmendët.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zonja Jorgaqi!

Vetëm në Shqipëri mund të ndodhë që kodi të harmonizohet me ligjet dhe jo anasjelltas që ligjet të harmonizohen me kodet. Këtu nuk biem dakord, por nuk është hera e parë që

mendojmë ndryshe. Gjithsesi, kjo është një çështje që do të diskutohet dhe po e parashtroj që tani. Ne nuk do ta sjellim kodin në përputhje me ato, por, nëse është e nevojshme, ato do t'i ndryshojmë që të vijjnë në përputhje me kodin. Kodi në raport me ato projektligje ka epërsi. Besoj se këtu kemi të njëjtin mendim.

Zoti Frroku ka një pyetje.

Mark Frroku – Kam një pyetje shumë të shkurtër.

Sugjerimi juaj për Ministrinë e Drejtësisë, për këtë komision, por edhe për parlamentin shqiptar është që këto ligje të jenë standarde me Bashkimin European apo sipas një fjale të vjetër popullore që kemi ne, sipas vendit bëhet edhe kuvendi? Ne shpresojmë dhe do të ecim me hapa të shpejtë drejt Bashkimit European. Kjo është pyetja ime.

Fatmir Xhafaj – Zoti Rusch, a keni ndonjë koment lidhur me përputhshmërinë e projektit me përvojën dhe praktikën shqiptare?

Wolfgang Rusch – Parimi i parë është që ky draftkod ka një identitet shqiptar dhe në një shkallë shumë të madhe është totalisht në përputhje me standarde që ekzistojnë në vendet e BE-së.

Kjo tregon edhe se sa traditë dhe kulturë ligjore të përbashkët kanë vendet e Bashkimit European, sepse në këtë mënyrë është edhe më i lehtë harmonizimi. Megjithatë ka disa çështje të cilat do të kisha dëshiruar që të ishin më të harmonizuara, por ato nuk janë thelbësore dhe nuk janë të tilla që na bëjnë ta konsiderojmë draftin në tërësi jo në përputhje me standardet e Bashkimit European.

Si një ekspert i fushës do të doja të theksoja faktin që një ligj i caktuar është, në fund të fundit, një kompromis i interesave të ndryshme. Të gjitha ligjet kanë rëndësinë e tyre dhe për këtë doja të thosha që nuk është mirë që një ligj të shikohet vetëm nga një aspekt, por duhet të merren parasysh të gjitha aspektet. Për këtë unë mendoj se ky është një produkt i mirë dhe një kompromis i mirë.

Në qoftë se ne do të kemi mundësi të diskutojmë së bashku në detaje disa aspekte, të cilat unë i konsideroj të rëndësishme dhe do të biem dakord, mendoj se në fund fare do të kemi një produkt shumë të mirë dhe një kod që është në përputhje me standardet europiane.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Besoj se këtu e mbyllim edhe me pyetjet e kolegëve. Dëshiroj ta falënderoj përземërsisht zotin Rash për prezencën, për kontributin përmes ekspozesë dhe

vlerësimeve, por edhe sugjerimeve që paraqiti, të cilat do t'i kemi në konsideratë! Gjithashtu, vlerësoj edhe praninë e zonjës Bernhard sot në komision. Pa dyshim që do të kemi një rrugë të gjatë përpara së bashku dhe do të kemi rast të shkëmbejmë mendime për kodin dhe për çështje të tjera.

Në përmbyllje të kësaj seance dëshiroj të them se ekspozēja që paraqiti eksperti i SIGMA-s, por edhe minutat e takimit të paraqitura nga Ministria e Drejtësisë lidhur me dy takimet e fundit të shtatorit dhe ai i djeshëm ndërmjet ministrisë dhe SIGMA-s na çojnë në përfundimin se ka ende një sërë çështjesh të pambyllura përfundimisht. Natyrisht që do të duhet që Ministria e Drejtësisë të sjellë zyrtarisht se cilat janë ndryshimet që i bëhen draftit që ka sjellë qeveria me iniciimin e Ministrisë së Drejtësisë dhe cilat janë pikat ku ndahen aktualisht që nuk kanë gjetur reflektim në draftin që ne do të marrim në shqyrtim, në mënyrë që kolegët gjatë shqyrtimit të projektligjit t'i marrin në konsideratë si çështjet që janë përafëruar në qëndrime midis ekspertizës dhe ministrisë, por edhe çështjet që janë pezull dhe që kanë nevojë për një vëmendje të veçantë.

Relatori, zoti Subashi, i cili për një arsye objektive nuk është sot në këtë mbledhje komisioni, do të organizojë shumë shpejt dhe në një kohë të përshtatshme për ekspertizën ndërkombëtare një tryezë punë (kur them tryezë punë, nuk e kam fjalën për ato tryezat që më përpara dalin në media se bëjnë punë, por nga ato që mund të mos dalin fare në media, por që bëjnë punë konkrete) në të cilën do të marrin pjesë ekspertë të fushës që janë angazhuar dhe, për fat të mirë, ne e kemi këtë ekspertizë në vendin tonë, ekspertët e SIGMA-s, besoj edhe EURALIUS-i.

Dëshiroj shumë dhe përfitoj nga rasti të ftoj opozitën të jetë e pranishme si në mbledhjen e komisionit gjatë shqyrtimit të këtij projektligji të rëndësishëm, edhe në këtë tryezë pune, sepse ky është një projekt i nisur gjatë maxhorancës së kaluar, por e rëndësishme është se ky projekt nuk është as për opozitën dhe as për maxhorancën, por është për qytetarin dhe për të ardhmen e vendit.

Nga ato që u thanë këtu do të doja të ritheksoja dy gjëra.

E para, cilësia e projektit është më e rëndësishme se çdolloj shpejtësie, edhe kur ajo vjen nga qeveria apo kur vjen nga Brukseli. Shpejtësia prevalon edhe me interesat e qeverisë në një moment të caktuar, edhe me interesat e Brukselit në një tjetër moment për arsye të pranueshme dhe të mirëkuptueshme.

Ligji besoj se do të duhej të ishte më mirë në vëmendjen e ministrisë, por duhet të jetë më mirë edhe në vëmendjen tonë. Cilësia është mbi të gjitha dhe do të ketë vëmendjen e përbashkët, gjë për të cilën duhet të kujdesemi.

Çështja e dytë është qëllimi, është natyrisht reflektimi i standardeve dhe përvojave më të mira në këtë fushë, prandaj janë edhe ekspertët e nderuar. Unë mendoj dhe personalisht jam partizan i faktit që legjislacioni shqiptar tashmë ka nevojë për një vlerësim dhe reflektim më të mirë të traditës, të mentalitetit dhe të praktikës sonë. Ne nuk duhet të harrojmë që një ligj i mirë, i cilësisë së kërkuar është kur zbatohet mirë në praktikë. Të mos harrojmë që ky është një ligj që do të bëhet në Shqipëri për shqiptarët dhe do të zbatohet nga shqiptarët.

Kjo është shumë e rëndësishme për t'u marrë në konsideratë në proces dhe besoj se këtu nuk duhet të bëjmë kompromis. Të them të drejtën, ne që jemi këtu ia dimë edhe të mirat, edhe të këqijat kompromisit. Jemi të mbytur me kompromis. Fjala e fundit që do të doja të dëgjoja nga ekspertët është kompromis për cilësinë e ligjit. Ky kompromis duhet të ekzistojë. Le të shpresojmë që të gjithë bashkë do të bëjmë më të mirën!

Faleminderit për prezencën tuaj!

Faleminderit misionit EURALIUS dhe Ministrisë së Drejtësisë për kontributin dhe për bashkëpunimin!

MBLEDHJA MBYLLET